



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:216981

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05646793

KPPP.nr.35/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, Gjyqtari Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A, me NRB: 70325399, me seli në Prishtinë, rruga “Nëna Terezë” nr.36, kundër debitorit Barnatore A.C. B.I., me seli në Rahovec, rruga “...” p.n, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.686/18 të datës 20.12.2018 të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Barnatore A.C. B.I., ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.686/18 i datës 20.12.2018, i Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.686/18 të datës 20.12.2018, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist DGJ - 80008373 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t’ia paguajë kreditorit shumën prej 240.31 €, për periudhën kohore nga data 05.03.2011 deri më datë 28.03.2013, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm. Nëse debitori brenda afatit nuk e përmbush detyrimin, përmbartimi të realizohet përmes ndalimit të

mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogarinë rrjedhëse, ose përmes regjistrimit, vlerësimit, sekuestrimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme të debitorit të cilat ndodhen në posedim të tij deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se shpenzimet e kërkuara nga kreditori nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i ka shkaktuar debitori, ka shtuar se përmbartuesi është dashur ta kërkojë gjendjen nga kreditori, për të përcaktuar se për cilën periudhë kohore është duke kërkuar borxhin ndaj debitorit. Tutje ka shtuar se në këtë rast kemi të bëjmë me borxhin i cili është krijuar nga data 27.09.2009, e që sipas nenit 378 paragrafi 3 të LMD-së, në këtë rast kemi të bëjmë me vjetërsimin e kërkesës. Gjykatës i ka propozuar që ta abrogojë urdhrin përmbartimor, ndërsa debitorin ta liroj nga pagesa e borxhit.

Kreditore në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të paargumentuar me asnjë provë. Ka theksuar se sa i përket pretendimit të debitorit se nuk dihet se për cilën periudhë kohore është kërkuar përmbartimi, i njëjti është ushtruar për periudhën 05.03.20211 deri me datë 28.03.2013, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht ekstraktit nga librat afarist. Tutje ka shtuar se debitori ka bërë nënshkrimin e deklaratës mbi dakordimin e borxhit si dhe kontratën për pagesën e borxhit, andaj nuk qëndrojnë pretendimet se borxhi është parashkruar, pasi që sipas nenit 368 të LMD-së paragrafi 2, është përcaktuar se pranimi i borxhit mund të bëhet edhe në mënyrë të tërthortë, në rastin konkret pranimi i borxhit është bërë me nënshkrimin e deklaratës për pagesën e borxhit si dhe kontratës për pagesën e borxhit. Gjykatës i ka propozuar që ta lë në fuqi urdhrin përmbartimor.

Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm lidhur me këtë çështje përmbartimore me Aktvendimin PPP.nr.17/2019 të datës 12.11.2021, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin përmbartimor P.nr.686/18, të datës 20.12.2018, dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor.

Debitori me datë 13.12.2021, ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, konstatim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e

bazuar ankesa e debitorit, të anulohet aktvendimi dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, me Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.199/23 të datës 04.07.2023, ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit dhe ka anuluar aktvendimin PPP.nr.17/2019 të datës 12.11.2021, të Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, gjykata pas vlerësimit të ekstraktit nga librat afariste dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 355 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit e cila rrjedhë nga Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist DGJ - 80008373, është parashkruar.

Me dispozitën e lartcekur të nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se: *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të nenit 355 parashihet se: 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer.”*

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat nga data 05.03.2011 deri me datën 28.03.2013 në shumën prej 240.31 €, janë parashkruar sipas nenit 355 të LMD, pasi që propozimi i kreditorit për përmbartim është paraqitur me datë 20.12.2018, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit

sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e maturimit / arritjes për pagesë.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Gjykata gjeti se kërkesa e kreditorit për faturat nga data 05.03.20211 deri me datën 28.03.2013, është parashkruar, andaj e aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorit, dhe anuloi urdhrin për përmbarim P.nr.686/18 të datës 20.12.2018, të Përmbaruesit Privat Gëzim Gjoshi, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e kreditorit se në rastin konkret debitori përmes nënshkrimit të kontratës dhe pagesave të kësteve, është ndërprerë parashkrimin konform dispozitave të nenit 368 par. 1 të LMD-së, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara për faktin se sipas Kontratës për pagesën e borxhit, Deklaratës mbi Dakordimin e borxhit si dhe Deklaratës mbi Poseduesin faktik Nr. 34540 të datës 26.08.2016, nënshkrues është personi K.Sh.H., i cili sipas propozimit për përmbarim të lejuar sipas urdhrit përmbarimor P.nr.686/18 të datës 20.12.2018, nuk është palë debitore në këtë procedurë përmbarimore. Andaj rrjedhimisht gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston një marrëveshje në mes kreditorit dhe debitorit e cila do të ndikonte në rrjedhën e afatit të parashkrimit, përkatësisht në ndërprerjen e parashkrimit.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për I Përgjithshëm

KPPP.nr.35/24 datë 30.04.2024

Numri i lëndës: 2021:216981
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05646793

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.